Архивски знак: 0201
Shenja arkivore:
Рок на чување: 1
Afati i ruajtjes:
01.04 2025 година
Потпис
Nënshkrimi
viti

INSTITUTI NACIONAL
ORKESTRA E XHAZ MUZIKËS E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
Бр.-Nr. 02-227/6
01.04 2025 год.-viti

ва на член ста

PROPOZIM
GJEDHE

Në bazë të nenit 16, paragrafi (1), pika 1 të Statutit të Institucionit Nacional "Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut", a në lidhje me nenin 77-g të Ligjit të Kulturës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/1998; 49/2003; 82/2005; 24/2007; 116/2010; 47/2011; 51/2011; 136/2012; 23/2013; 187/2013; 44/2014; 61/2015; 154/2015; 39/2016), Këshilli drejtues i Institucionit Nacional "Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut", në mbledhjen e mbajtur më 1.4.2025, miratoi:

INSTITUCIONI NACIONAL
"ORKESTRA E MUZIKËS JAZZ E RMV-së"

RREGULLORE

Për procedurën e plotësimit të vendit të punës me punësim për kategoritë A - artistë, B - bashkëpunëtorë artistikë për përgatitjen e veprave skenike dhe muzikore-skenike, dhe G - bashkëpunëtorë profesionalë në veprimtaritë nga fusha e kulturës, për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike dhe të aplikimit për punësim, mënyrën e zbatimit të seleksionimit dhe intervistës, përkatësisht audicionit.

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet procedura për plotësimin e vendit të punës me punësim për kategoritë A - artistë, B - bashkëpunëtorë artistikë për përgatitjen e veprave skenike dhe muzikore-skenike, dhe G - bashkëpunëtorë profesionalë në veprimtaritë nga fusha e kulturës, forma dhe përmbajtja e shpalljes publike dhe e aplikimit për punësim, mënyra e realizimit të seleksionimit dhe intervistës, përkatësisht audicionit.

Neni 2

Për fillimin e procedurës për plotësimin e vendit të punës, drejtori i institucionit miraton vendim për nevojën e punësimit, i cili përmban numrin dhe datën e Planit vjetor të punësimit, në bazë të të cilit realizohet procedura e punësimit, si dhe emërtimin e vendeve të punës për të cilat do të zbatohet procedura.

Shpallje publike

Neni 3

Shpallja publike për plotësimin e vendit të punës përmban:

- stemën dhe emrin e republikës, si dhe logon dhe emërtimin e institucionit,
- bazën për publikimin e shpalljes publike,
- numrin e shpalljes publike,
- për çdo vend pune të ndryshëm në shpallje: numrin rendor, kodin, emërtimin dhe numrin e ekzekutuesve,
- për çdo vend pune të ndryshëm në shpallje: kushtet e përgjithshme (në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive), kushtet e veçanta (arsimin, përvojën e punës, kompetencat e përgjithshme dhe të veçanta të punës sipas aktit të sistematizimit të Orkestrës së Muzikës Xhaz),

- për çdo vend pune të ndryshëm në shpallje: orarin e punës, fillimin dhe përfundimin e orarit ditor dhe javor të punës,

- për çdo vend pune të ndryshëm në shpallje: shumën neto të pagës në para,

- afatin për dorëzimin e aplikimit për punësim,

- mënyrën dhe vendin ku duhet të dorëzohet aplikimi dhe dokumentet e detyrueshme për përmbushjen e kushteve për punësim,

- informacion të shkurtër për mënyrën e zhvillimit të procedurës (fazat: kontrolli i aplikimit dhe dëshmive, si dhe intervista/audicioni).

Neni 4

(1) Shpallja publike për punësim publikohet në uebfaqen e institucionit publik nga fusha e kulturës dhe në të paktën tre gazeta ditore, prej të cilave njëra nga gazetat që botohet në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(2) Në shpalljen publike përcaktohet kategoria, niveli dhe kushtet për plotësimin e vendit të punës.

(3) Afati për aplikim në shpalljen publike nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë nga dita e publikimit të saj në gazetat ditore.

Aplikimi për punësim

Neni 5

Aplikimi për punësim në një vend pune, veçanërisht përmban:

- të dhëna për kandidatin (emri dhe mbiemri, data dhe vendi i lindjes, adresa dhe vendbanimi, adresa elektronike e kandidatit, numri i kontaktit, përkatësia në komunitet),
- biografi të shkurtër,
- letër motivimi,
- deklaratë për përmbushjen e kushteve të përgjithshme për vendin e punës, duke shënuar PO/JO për secilin kusht veçmas,
- deklaratë për përmbushjen e kushteve të veçanta për vendin e punës, duke shënuar PO/JO për secilin kusht veçmas,
- deklaratë për përmbushjen e kushtit shtesë nga shpallja, duke shënuar PO/JO për secilin kusht, nëse kërkohet.

Kandidatët mund të dorëzojnë edhe dëshmi për trajnime dhe përsosje profesionale shtesë në lidhje me vendin e punës që plotësohet.

Komisioni i procedurën së unësimit

Neni 6

(1) Për zbatimin e procedurës së punësimit, drejtori i institucionit, me aktvendim, formon Komisionin për Procedurën e Punësimit.

(2) Komisioni për Procedurën e Punësimit përbëhet nga: një kryetar dhe dy anëtarë, si dhe zëvendësit e tyre. Kryetar i komisionit është personi drejtues i njësisë organizative në të cilën plotësohet vendi i punës; një anëtar është person drejtues nga njësia organizative për burime njerëzore, ndërsa një anëtar tjetër është një person që ushtron funksion drejtues.

(3) Në rast se komisioni nuk mund të formohet nga tre të punësuar në pozita drejtuese, ai përbëhet nga tre të punësuar me statusin e ofruesve të shërbimeve publike në fushën e kulturës dhe një anëtar nga njësia organizative për burime njerëzore.

Neni 7

(1) Procedura e përzgjedhjes për punësim përbëhet nga verifikimi i vërtetësisë së të dhënave të paraqitura në aplikimin për punësim me dëshmitë e dorëzuara sipas shpalljes publike, me qëllim që të përcaktohet nëse kandidatët i plotësojnë kushtet e shpalljes publike.

(2) Pas përfundimit të përzgjedhjes së kandidatëve, komisioni përpilon procesverbal. Procesverbalit, për secilin vend pune të ndryshëm të shpallur, i bashkëngjitet lista e kandidatëve me aplikime të parregullta dhe të rregullta, me këto të dhëna: emri dhe mbiemri i secilit kandidat me aplikim të parregullt dhe arsyeja e parregullsisë së tij, emri dhe mbiemri i kandidatëve me aplikim të rregullt, si dhe lista e kandidatëve që vazhdojnë në intervistë/audicion.

(3) Kandidatët që e kanë kaluar me sukses procedurën e verifikimit të vërtetësisë së dëshmive kanë të drejtë të vazhdojnë në intervistë, përkatësisht në audicion për artistët.

Mënyra e zhvillimit të intervistës

Neni 8

(1) Intervista e kandidatëve për punësim zhvillohet nga komisioni.

(2) Gjatë intervistës, nëpërmjet pyetjeve vlerësohen kompetencat e nevojshme për kategorinë dhe nivelin të cilit i përket vendi i punës.

(3) Kandidatët njoftohen për ditën, orën dhe vendin e zhvillimit të intervistës në adresën elektronike dhe numrin e telefonit të shënuar në fletëparaqitje.

(4) Në intervistë mund të parashtrohen pyetje në formë gojore, me shkrim ose në kombinim të të dyja formave.

(5) Intervista përbëhet nga pyetje të përcaktuara në formularë të përgatitur paraprakisht, përkatësisht: pyetje të përgjithshme, nëpërmjet të cilave vlerësohen interesi dhe motivimi i kandidatit për vendin e punës; pyetje lidhur me përvojën e mëparshme të punës (nëse ka); pritjet e kandidatit nga punësimi dhe të ngjashme; pyetje situative, nëpërmjet të cilave vlerësohen kompetencat e përgjithshme të punës të nevojshme për kategorinë së cilës i përket vendi i punës; si dhe pyetje profesionale ose detyra praktike, nëpërmjet të cilave vlerësohen kompetencat e veçanta të punës që lidhen me fushëveprimin e vendit të punës.

(6) Komisioni i vlerëson kandidatët duke plotësuar formular për secilin kandidat, ku kandidati për secilin grup pyetjesh mund të marrë nga 5 deri në 10 pikë.

(7) Lista e renditjes së kandidatëve përcaktohet në bazë të shumës së pikëve. Në rast se dy ose më shumë kandidatë marrin numër të njëjtë pikësh nga komisioni, bëhet renditja e tyre sipas numrit të vlerësimeve më të larta që ka marrë secili kandidat.

(8) Për intervistën e zhvilluar, komisioni harton procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit. Procesverbali përmban këto të dhëna: datën, kohën dhe vendin e zhvillimit të intervistës, numrin e shpalljes, kandidatët e ftuar në intervistë, kandidatët që kanë marrë pjesë në intervistë, pikët e fituara, listën e renditjes së kandidatëve me shumën e pikëve, si dhe emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e anëtarëve të komisionit.

(9) Procesverbalin me listën e renditjes së kandidatëve, propozimin për kandidatin dhe vlerësimet përmbledhëse për secilin kandidat, komisioni ia dorëzon drejtorit brenda tre ditëve, me qëllim marrjen e vendimit për përzgjedhje. Bashkëngjitur me procesverbalin dorëzohen edhe LISTAT e vlerësimit nga intervista e zhvilluar.

Neni 9

Në bazë të procesverbalit të dorëzuar nga komisioni, brenda pesë ditëve nga marrja e propozimit, drejtori është i detyruar të marrë vendim për përzgjedhjen, i cili u dorëzohet kandidatëve dhe publikohet në ueb-faqen dhe tabelën e shpalljeve të institucionit.

Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankese pranë Këshillit drejtues të IN Orkestra e Muzikës Xhaz, brenda tetë ditëve nga dita e pranimit të vendimit për përzgjedhje.

Neni 10

Në afat prej pesë ditëve nga dita kur vendimi për përzgjedhje bëhet përfundimtar, drejtori merr vendim për punësim dhe me kandidatin e përzgjedhur lidh kontratë pune, në pajtim me dispozitat ligjore.

Audicioni

Neni 11

(1) Në audicion vlerësohen aftësitë artistike të kandidatit.

(2) Kandidatët njoftohen për ditën, orën dhe vendin e zhvillimit të audicionit në mënyrë elektronike dhe në numrin e telefonit të shënuar në fletëparaqitje.

(3) Mënyra dhe procedura e zhvillimit të audicionit, si dhe vlerësimi me pikë i kandidatëve, përcaktohen në Rregulloren për zhvillimin e audicionit të Orkestrës së Muzikës Xhaz të RMV-së, në të cilën janë përcaktuar kriteret që artistët janë të detyruar t'i plotësojnë.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 12

Dispozitat e kësaj Rregulloreje, përveç dispozitave që kanë të bëjnë me zhvillimin e audicionit, do të zbatohen edhe për zhvillimin e procedurës së punësimit për vendet e punës që sipas aktit të sistematizimit, janë përcaktuar si vende pune ndihmëse-teknike.

Neni 13

Këtë Rregullore e miraton Këshilli drejtues i IN Orkestra e Muzikës Xhaz.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë të parashikuar për miratimin e saj.

Neni 14

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj. Rregullorja do të publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në ueb-faqen e institucionit.



Претседател на У

Сашко Николовски